

## KANUNI I MATH

### SHERBËSA

#### Ë KANUNIT LUTJËSOR TE MATH TE HYJLINESËS SE PERMISHËNJTE

(Prëj mbrëtit Théodor Duka Láskari).

Passi bëkon Prifti, thuhën te tjerat si të Kanuni Lutjësor i Vogel.  
Pastaj ky KANUN :

#### *Kënge I. — E. T. IV.*

Qéréngasesin Faraon é mbyti nje hère çuditerisht shkop' i Moisiut, dyké goditur kryqthi dhé dyké ndare détin, dhé Israélin qe ikté udhetar me këmbe é shpetoj, kënge Pérendise dyké kenduar.

Dimer hidherimi mi Shpirtin t' im te perunjur, édhé ré mjérimësh me mbulojne zemren, ô Nus' é Pérendise; po ti, qe lindé driten é hyjeshmé dhé te parejéteshmé, ndrit-me mé driten é gezuarshmé.

Nga shtrengimé te panúmerta dhé hélmé dhé nga armiq te keqij, dhé nga mjérimé jété si shpetova, é Panjollëshmé, mé fuqine tëndé te potéreshmé, madheshtoj mé hymné meshiren tëndé te pamatur édhé ngushellimin qe me dhè.

Té perkraha joté é forte pata básim édhé perika me ty, dhé té mprojtja joté tanì rénda mé gjithë shpirt, dhé pshéretij, ô Zonje, dhé vajtoj i pergjunjur : Mua te mjérim mos me çperhith, ti qe jé perikja é te Krishtërevé.

Se thirruri nuk do pushoj madheshtirat é tua fort te medha; sé po te mos me mpronjé ti, ô Vajze gjithenje, dyké nermjétuar té Biri yt dhé Pérendia, kush do t' me

shpetonté nga shqoterat édhé nga rézikét é tmëruara?

Hyjlindesé, sherbetoret é tu i shpetô nga rézikét, sé te gjithë pas Pérendise perikim té ty, si té nje mprojtjé dhé nje keshtjélle é paçare.

Hyjlindesé é perhymnuar, hith syrin mé miresl té mundimi i lik i trupit t' im dhé sherô-me dhembjén é shpirtit.

#### *Kënge III.*

O Zot, qe kulmové arken é qiëlleshmé, dhé ndertové Kishen, ti me shigurô té dashuria joté, maja é deshiravé, pshtétja é básnikévé, i vétém njéridashes.

I deshperuar se gjithash, te therrés mé hidherim : Arrì, ô mprojtj' é nxéhte, dhé ném ndihmen tëndé mua sherbetorit tënt, te perunjur é te mjére, qe lyp perkrajhén tëndé mé nxéhtesi.

Me té vertéte me béré, ô Zonje Vajze, tanì mirebêrjé dhé meshira te çudiçimé; perandaj te lavderoj dhé perhymnoj kujdésin tënt te shume dhé te pamatur.

O Zonje, me zuri shqota dimeroré é mjérimévé, dhé shtergata préj hélmësh po me mbytin tanì; po ti arrì é ném dore ndihmetaré, ô perkrahesja imé dhé mprojtésé.

Hyjlindesé te fieshte, ô Zonje, te rreféj ty qe abolité potéren é vdékjés; sé, si jételindesé, nga vargojt' é Sketérres me ngrité ne jéte mua qe rashe per dhé.

Hyjlindesé, sherbetoret é tu... (*Shih më sipër, té fund' i Kënges I*).

Hyjlindesé é perhymnuar... (*Shih më sipër, té fund' i Kënges I*).

#### *Ndenjesoré. T. II.*

Nermjétim i nxéhte dhé keshtjélle é paluftuarshmé, burim meshiré, perikjé é botes, te therrésim nxéhterisht : Zonje Hyjlindesé, arrì é na çperblé nga rézikét, ô é vétém qe mpron mé shpéjtim.

*Kënge IV.*

Ti jé forca imé, Zot, potéra imé ti jé; ti jé Pérendia imé, ti jé ngazellimi im, qe pa lêne gjirin ateror, vizitové dhé varferine tone. Perandaj mé Profétin Abbakum te therrés : Lavdl fuqise s' até, ô njéridashes.

Dhé kû gjétke perkrahjé do te gjéj? Kû do te perikej, édhé ku do te shpetoj? Cilen ndihmesé te nxéhte do te kém un' i mjéri qe tronditém préj hélmévé te jétes dhé préj shqotavé? Me ty vétem kam shprése, dhé kuxoj édhé mburrém, dhé rént té hija joté. Ti me shpetô.

Lumin é embel te perdellimit têt, qe mé dhurata te pasura vésoj, ô é Qashter, shpirtin t' im te mjér' é te perunjur, qe u-flagesua ne furre te mjéresivé dhé te hélmévé, madheshtoj dyké leçitur, dhé rént té hija joté. Ti me shpetô.

Ty te qashteren, ty Virgjeréshen é panjolleshmé, ty te kam vétem keshtjéle te paluftuarshmé, perikjé, mprojtjé te potéreshmé, arme shpetimtaré. Mua prodigun mos me çperhith, ô shprés' é te deshperuarvé, ndihm' é te semurevé, gazi dhé perkrahja é te hélmuarvé.

Si do te munt pas vléres te trégoj meshirat é panumerta, ô Zonje, qe vésuane si uje réth perqark shpirtit t' im ngahére qe flagesohéj tmérresiht? Oh proja joté édhé mirebêrja, nga é cila u-gezova véte ploterisht.

Hyjlindesé, sherbetoret é tu...

Hyjlindesé é perhymnuar...

*Kënge V.*

Persé me hodhé téj préj faqés s' até, ô drit' é papérenduarshmé, dhé me mbuloj te mjérin érrésira armiké per gjithenje? Po kthé-me prape, dhé té drit' é porosivé te tua, te lutém, udhen m'a dréjtesô.

Te therrés, dyké perhiruar : Gezohu, Nën' é virgjer;

gezohu, Nus' é Pérendise; gezohu, hié é hyjeshmé; gezohu, arme dhé keshtjéll' é pazaptuarshmé; gezohu, mprojtjé dhé ndihmesé dhé shpetim i atyré qe perikin me ty besérisht.

Shigjéta dhé shpata édhé grope gatitne atà qe me urréjne me kot, édhé po kerkojne trupin é mjére te me çierin, dhé te me zbrésin ne dhé, ô é Qasther, perpiqén. Po arrì dhé préj ketyré ti me shpetô.

Nga ç' dô névoje, hidherim dhé lengate, édhé dêm me shpetô, dhé mé forcen tëndé té hia joté te pangare ruaj-me préj ç' dô réziku dhé préj armiqsh qe me leftojne dhé me urréjne, ô Vazj' é perhymnuarshmé.

Ç' fare dhurate perhirimi te te siéll per sa gezova nga ty, per dhurimét é tua dhé per miresine tëndé te patréguarshmé? Andaj pra lavderoj, perhymnoj dhé madheshtoj meshiren tëndé per mua qe nuke thuhét dot.

Hyjlindesé, sherbetoret é tu...

Hyjlindesé é perhymnuar...

*Kënge VI.*

Te falurit t' im Pérendise do t' ia dérth, dhé atf do t' i trégoj hidherimét é mia; sé shpirti im u-mbush mé te keqia dhé jéta imé u-afrua mun' ne Férr; dhé lutém posi Jonaj : Nxir-me préj prishjés, ô Pérendi.

Ré hélmesh é mbuluan shpirtin t' im édhé zemren t' imé te mjére, édhé m' u-érr mendja imé, ô Vajze; po ti, qe lindé driten é paafruarshmé, dbô-i ketô te gjitha lark, mé frymesimin é nermjétimet têt te hyjeshme.

Ner hélmét ty te di per ngushellim, dhé te njoh per sheronjes lengatash, édhé dermim te plotte te vdékjés, édhé lume jété te paçpusuarshim, dhé per gjitha sa jane ne mjérim jé perkrahjé é mpréhte dhé é shpéjteshmé.

Théllesiren é meshires s' até nuk é fshéh, as burimin é çudivé pa mase; sé krua jé ti, i pasosur mé te vertéte,

préj perdellimi per mua, ô Zonje; po therrés é leçit é i thom te gjitha dhé i trégoj.

Andrallat é jétes me rréthuan, posi nblétet qiririn, Virgjeréshe, dhé shpirtin t' im é zaptuan dhé é plagosin mé shigjéat é hélmévé; po ndihmesé te gjéça ty, édhe dbonjesé dhé shpetimtaré, ô é Panjolleshmé.

Hyjlindesé, sherbetoret é tu...

Hyjlindesé é perhymnuar...

*Shkurtoré. — T. II.*

Mprojtésh' é te Krishtërevé... (*Shih té Kanuni Lutjësor i Vogel, f. 74*).

UNGJILL. — PAS LUKAJT.

M' atê kohe, hyri Jësuj ne nje fshat; dhé nje grua mé émer Martha, é priti ne shtëpë te saj. Dhé ajò kish nje motre, qe quhéj Maria, é cila ndenji prane këmbevé te Jësujt dhé degjonté fiolet é tij; dhé Martha mundohéj shume, dyké sherbyér, dhé qendroj é tha : « Zot, nuke dô te dish qe imé-motre me lâ vétém per te sherbyér? Thuaji pra te me ndihe. » Dhé u-pergjéq Jësuj é i tha : « Marthe, Marthe, kujdésesh é trubullohësh per shune, po per një eshte névoje; dhé Maria zgjodhi piésen é mire, é cila do mos mérrét préj saj. » Dhé, me te thêne ay ketô, nje grua préj turmes ngriti zêrin é i tha : « Lum barku qe te mbajti dhé siset qe thethité ». Dhé ay tha : « Jo-po lum' atà qe degjojne fialen é Pérendise dhé é ruajne. »

Pasandaj thuhén gjith' atò kendimé si té Kanuni Lutjësor i Vogel (*Shih f. 75*). Pastaj :

*Kênge VII.*

Diémat é Hébréjvé shkêle mé kuxim flagen é fures, édhe ziarrin me vése é ndryshuan, dyké thirrur : I békuar jé, ô Zot, ô Pérendi, per jéte.

Hyjlindesé, qe lindé driten, mua t' érrësuarit me nate mekatésh ép-me drite ti, dyké qêne éne drité é paqmé dhé é panjolleshmé, qe te te lavderoj mé mall.

Bêhu hié dhé mprojtjé, perkrahjé dhé mburrjé per mua, Virgjeréshe, qe jam çvëshur tanë préj çfaredô ndihmé, ô forc' é te pandihmuarvé, dhé shprése é te deshperuarvé.

Mé gjithë shpirt é mendjé dhé zemer dhé buze te lavderoj, sé gezoj gjithenje dhuratat é tua te medha. Oh, miresia joté, dhé çudit' é tua pa mase !

Hith syrin têt te meshireshme dhé shih mundimin, ne te cilin ndodhém; édhe ti me shpetô nga mjérimét é tmérruara, dhé dêmét, dhé rézikét, dhé ngasjét, mé meshiren tëndé te pamatur.

Hyjlindesé, sherbetoret é tu...

Hyjlindesé é perhymnuar...

*Kênge VIII.*

Zotin, qe u-lavderua té mal' i shenjteruar dhé i bêri te njohur Moisiut mé ziarr ne férre myshtërin é gjithmon-virgjerës, hymnojéni dhé perhymnojéni per gjithë jétet.

O Virgjerésh' é ndéruar, kij meshire dhé mos me çperhith mua qe mbytém té shqota é valevé te jétes; po ép-me dore ndihmé, sé po mundohém ne ligesit' é jétes.

Rasjé dhé hélmé dhé shtrengimé me gjétne, ô é Qashter, dhé mjérimé te jétes dhé ngasjé me rréthuan nga kudô; po qendrô prane méjé dhé perkrah-me mé mprojtjén tëndé te forte.

Ner shqotat te kam gjétur per liman, gezim dhé defrim ner hidherimét, dhé ner lengatat ndihme te shpéjte, shpetimtaré ner rézikét, dhé mprojtéshe ne ngasjét.

Gezohu, fron i ziarrfytyreshme i Zotit; gezohu, shtëmbe é hyjeshmé dhé mannapritesé; gezohu, kandil i arte, lampade é pashuar; gezohu, lavdi é virgjerëshavé, zbukurim dhé laft i nënavé.

Hyjlindesé, sherbetoret é tu...

Hyjlindesé é perhymnuar...

*Kênge IX.*

Qiëlli u-çudit per ketê gjê, édhé anet é dhéut u-mahnitne, sé Pérendia u-duk ner njërezit truperisht, dhé gjiri yt u-trégua mê i gjêre sé qiéjte. Perandaj, Hyjlindesé, te madheshtojne urdherét é njëresvé dhé te Engjejvé.

Kú gjétke te perikej, ô é Qashter? Kú te vété gjétke dhé te shpetoj? Kú munt te shkoj, dhé cilen perikjé te gjéj, cilen perkrahjé te nxéhte, cilen ndihmesé ne hidherim? Me ty vétém kam shprése, dhé me ty vétém mburrém, édhé me ty perikej mé guxim.

Nus' é Pérendise, nuke munt madheshtit' é tua te numuroj, dhé te trégoj théllesiren é pashploruarshmé te çudivé te tua permi ment, qe ké bêre gjithenje per atà qe te ndérojne mé mall dhé t' adhurojne mé bése si te vertéte Hyjlindesé.

Mé hymné perhirimi te lavderoj dhé kendoj meshiren é pamaturshmé, dhé potéren tëndé te shume é rreféj, dhé leçit mirebêrjé é tua qe zbrazé mi mua ploterisht, dhé i madheshtoj mé shpirt, mé zemer, mé ment dhé mé gjuhe gjithenje.

Lutjén t' imé te varfer prit, dhé mos çperhith qarjé, pshéretimé édhé lot; po perkrah-me si é mire, dhé lypjé t' imé i mbarô; sé munt t' i bêsh te gjitha, si Nën' é Zotit Pérendi te forte, po te unjésh vétém té perunjësia imé é meshireshmé.

Hyjlindesé, sherbetoret é tu...

Hyjlindesé é perhymnuar...

Dhé te tjérat, si té Kanuni Lutjesor i Vogel. Pas Trishénjtit, thuhén mé zé te larte dhé ngadalé ketô :

*Dergimesoré. — T. III.*

O Apostuj, qe u-mblothte ketu prëj anevé te dhéut,

ne fshat Géthsémané, varrosm'ani trupin; dhé ti, ô Bir dhé Pérendia imé, mérrm'a shpirtin.

O embelsir' é Engjejvé, gezim' i te hélmuarvé, mproj-tésh' é te Krishtërevé, Virgjeréshe Nën' é Zotit, perkrah-me dhé shpetô-me nga mundimét é perjéteshmé.

Ty te kam nermjétaré té njëridashesi Pérendi; véprat é mia mos i nxonit perpara Engjejvé. Te lutém, ô Virgjeréshe, shpéjtô édhé ndih-me.

Ture é éndur mé ar, qytét i dymbedhjétemureshme, fron qe pikon diéll, ô fron' i Mbrétit, çudi é pakuptu arshmé, si i jép qumusht Zotit?

